

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d) dhe nenit 14 paragrafi 1 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e RKS-së" nr.28/2008), nenit 13 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës nr.06/L-092 ("Gazeta zyrtare e RKS-së" nr.10/2019), nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e nëntë të rregullt, e mbajtur më datën 27.12.2024, merr këtë:

VENDIM Nr.56/2024/KG

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË GRAÇANICËS TË DESTINUARA PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM PËR VITIN 2025

Neni 1

Miratohet Vendimi për miratimin e listës së pronave të paluajtshme të komunës të destinuara për dhënien në shfrytëzim për vitin 2025.

Neni 2

Lista e pronave të paluajtshme të komunës të dhëna në shfrytëzim përbëhet nga pronat e mëposhtme:

Nr.r .	Të dhënat kadastrale	Përshkrimi	Destinimi	Data e publikimit	Afati kohor
1	Parcela nr.1355-1 ZK Llapllasellë	Pjesa e parcelës nr.1355-1 ZK Llapllasellë, sipas PZhK-së të vlefshëm për periudhën 2014-2029. është paraparë për ndërtimin e objekteve publike	Ndërtimi i stacionit të zjarrfikësve	Gjatë vitit 2025	Shfrytëzim afatgjatë
2	Parcela nr.17-8 ZK Graçanicë	Pjesë e parcelës kadastrale nr.17-8 ZK Graçanicë	Ndërtimi i impiantit për prodhimin e energjisë elektrike nga	Gjatë vitit 2025	Shfrytëzim afatgjatë


			energja diellore		
3	Parcela nr.1006-1 dhe 1006-3 ZK Gushterica e Poshtme	Parcelat ndodhen në zonën e biznesit, e cila është përcaktuar me PZhK-në ekzistues për periudhën 2014-2029	Ndërtimi i objekteve afariste	Gjatë vitit 2025	Shfrytëzim afatgjatë
4	Parcela nr.305-0 ZK Suhadoll	3 lokale në Suhadoll	Ushtrimi i aktivitetit afarist	Gjatë vitit 2025	Shfrytëzim afatshkurtër
5	Parcela nr.603-0 ZK Lepinë	2 lokale në Lepinë	Ushtrimi i aktivitetit afarist	Gjatë vitit 2025	Shfrytëzim afatshkurtër
6	Parcela nr.509-0 ZK Llapllasellë	4 lokale në Llapllasellë	Ushtrimi i aktivitetit afarist	Gjatë vitit 2025	Shfrytëzim afatshkurtër
7	Parcela nr.1434-2 ZK Graçanicë	Lokalet në QT Graçanicë	Ushtrimi i aktivitetit afarist	Gjatë vitit 2025	Shfrytëzim deri në 1 vit
8	Parcela nr.516-0 ZK Gushterica e Poshtme	Lokalet në QT Gushterica e Poshtme	Ushtrimi i aktivitetit afarist	Gjatë vitit 2025	Shfrytëzim deri në 1 vit

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi janë përgjegjëse drejtoritë komunale.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi nga dita e publikimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.



Kryesuesi i Kuvendit

Milan Dimitrijević